

**UDHËZIME PËR PROCEDURËN (FAZAT) E PARAQITJES, VLERËSIMIT  
DHE MBROJTJES SË TEMAVE MASTER**



Zyra e Dekanit  
FAKULTETI JURIDIK · UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Këto udhëzime kanë për qëllim sqarimin e aspekteve procedurale (fazave) në lidhje me paraqitjen, vlerësimin dhe mbrojtjen publike të temave në studimet Master. Udhëzimet bazohen në rregulloret në fuqi të UP-së për studimet Master, respektivisht rregulloret:

1. Rregulloren për studime Master, nr. 2/922 datë 24.10.2019 dhe
2. Rregulloren nr./2/640, datë 19.11.2020, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, nr.2/922.

## **FAZA I**

### **PARAQITJA E PROJEKT PROPOZIMIT TË TEMËS (F1)**

1. Kandidati/ja e paraqet temën në bazë të kërkesës (F1), të cilën e parashtron në Katedër/Departament, nëse ka përfunduar të gjitha provimet e semestrit të parë.
2. Bashkangjitur formularit F1, kandidati/ja duhet të paraqes edhe: *Arsyetimin e temës së propozuar; qëllimin e studimit; përmbledhjen e literaturës; pyetjen hulumtuese; rezultatet e pritura dhe referencat e literaturës.*
3. Në kërkesën F1, kandidati/ja propozon mentorin. Mentor i temës mund të jetë secili mësimdhënës që mban titujt akademik Prof.Ass, Prof.Asoc apo Prof i rregullt.
4. Katedra, në afat, më së largu prej 30 ditë nga dita e paraqitjes, shqyrton kërkesën F1 (projekt propozimin), e kandidatit/es. Projekt propozimi mund të miratohet ose refuzohet nga Katedra/Departamenti.

5. Me rastin e miratimit të propozimit, Katedra e propozon edhe komisionin për vlerësim të temës. Pjesë e komisionit për vlerësim mund të jetë edhe mentori, jo në cilësinë e kryetarit, por vetëm si anëtar.
6. Këshilli i Fakultetit nxjerr vendim për miratimin e propozimit të temës F1 dhe miraton propozimin e Katedrës, bashkë me komisionin për vlerësimin e temës.
7. Kandidatit/es i dorëzohet vendimi i Këshillit të Fakultetit për miratimin e propozimit të temës dhe themelimin e komisionit për vlerësim.

## **FAZA II**

### **VLERËSIMI I TEMËS SË PUNUAR NGA KANDIDATI/JA (F2 dhe F3)**

1. Të paktën 3 muaj, pas vendimit të Këshillit të Fakultetit, për miratimin e propozimit të temës Master si dhe krijimit të komisionit për vlerësim, kandidati/ja, mund të paraqet kërkesë (formulari F2) në katedër (nëse e ka përfunduar punimin), me miratim të mentorit, për vlerësimin e dorëshkrimit (temës së punuar).
2. Kërkesa F2, bashkë me 3 kopje të buta të punimit të diplomës, dorëzohet në shërbimin për studimet Master të Fakultetit.
3. Në mbledhjen e radhës të katedrës, pasi kandidati/ja ta ketë paraqitur kërkesën F2, komisioni vlerësues paraqet raportin e vlerësimit të temës (F3).
4. Katedra mund ta miratoj ose jo raportin e vlerësimit F3. Në rast se e miraton raportin, i propozon Këshillit të Fakultetit krijimin e komisionit për mbrojtje publike të temës, bashkë me miratimin e raportit F3.

5. Së paku 5 ditë, para se të mbahet mbledhja e Këshillit të Fakultetit për aprovimin e raportit F3, një abstrakt i shkurtër i punimit master qëndron në ueb faqe të Fakultetit.
6. Këshilli nxjerr vendim për miratimin e raportit F3 dhe kandidati/ja kalon në fazën e mbrojtjes publike.

### **FAZA III**

#### **MBROJTJA PUBLIKE (F4)**

1. Pasi Këshilli i Fakultetit të ketë marrë vendim për miratimin e raportit të vlerësimit të temës (F3) dhe krijimin e komisionit të mbrojtjes publike, komisioni ka për obligim që të organizojë mbrojtjen publike, së paku 7 ditë prej datës kur Këshilli e merr vendimin.
2. Për organizimin e mbrojtjes komisioni dorëzon formularin F4 (raportin e mbrojtjes). Raporti dorëzohet në shërbimin master të Fakultetit.
3. Mbrojtja e temës bëhet jo më herët se 5 ditë dhe jo më vonë se 30 ditë, nga dita kur Këshilli i Fakultetit, e nxjerr vendimin për miratimin e komisionit të mbrojtjes dhe miratimin e raportit të vlerësimit (F3).
4. Sekretari i Fakultetit, shpall njoftimin për mbrojtjen publike, më së largu 5 ditë para datës së mbrojtjes, e cila është caktuar nga komisioni.
5. Nëse kandidati/ja nuk e mbron me sukses punimin, ai/ajo mund të paraqet propozim të ri të temës master dhe të njëjtin ta përfundojë në afat prej 6 muajve, nga dita e njoftimin për mos mbrojtën me sukses të punimit.
6. Kandidati/ja, para mbrojtjes publike e dorëzon punimin e diplomës master në 5 kopje.

## **SQARIME SHITESË**

1. Procesverbali i katedrave që i drejtohet Këshillit të Fakultetit, duhet të reflektoj qartësisht fazën në të cilën është tema e kandidatit/es (duke u referuar edhe në formularët përkatës F1, F2, F3 apo F4).
2. Çështjet e tjera rreth organizimit të studimeve Master, përfshirë edhe afatet janë të pasqyruara në:
  - Rregulloren për studime master, nr. 2/922 datë 24.10.2019 dhe
  - Rregulloren nr./2/640, datë 19.11.2020, për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores, nr.2/922.